

NEWSLETTER

EDICIONI I-rë



Tetor 2023–Mars 2024



Top News

Aleanca STARS EU në Universitetin Franche-Comté, Besançon në Francë. Lançimi i Konferencës Vjetore, në UAMD 2025.

Presidentit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara Hanze, Z. Dirk Johan Pouwels, i'u dorëzua Titulli i nderit "Doctor Honoris Causa"

STARS EU një histori suksesi

Në këtë edicion të parë të Newsletter-it të UAMD për STARS EU, ju ftojmë të lexoni në një udhëtim frymëzues përmes arritjeve, inovacioneve dhe historive të suksesit që kanë formuar Aleancën e Universiteteve Europiane STARS EU. Që nga krijimi i saj, STARS EU ka synuar të rrisë ndikimin e arsimit të lartë në shoqëri, duke ndërtuar një rrjet të fortë midis universiteteve partnere që ndajnë të njëjtën pasion për inovacionin, kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Nëpërmjet aktiviteteve të saj të shumta, që përfshijnë konferenca të rëndësishme, projekte inovative dhe iniciativa të qëndrueshme, STARS EU ka vendosur një standard të ri për bashkëpunimin akademik në Europë. Kjo Aleancë ka lejuar anëtarët e saj të shkëmbejnë ide, të ndajnë praktika të mira dhe të punojnë së bashku në projekte që synojnë të adresojnë sfidat globale dhe të ndikojnë pozitivisht në shoqëritë përreth tyre.

Ne jemi krenarë të prezantojmë disa nga momentet më të spikatura të 6-të mujorit të parë, duke përfshirë ceremoninë e nderit "Doctor Honoris Causa", konferencën vjetore në Universitetin Franche-Comté Besançon në Francë, dhe nismat e suksesshme të mbjelljes së fidanëve që simbolizojnë rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm.



Transforming Regions.
Empowering people.





Universiteti Franche-Comté, Besançon në Francë

Konferenca vjetore për Aleancën STARS EU në Universitet de Franche-Comté në Besançon, Francë 21-22 Mars, 2024 . Konferenca mirëpriti delegatë nga të gjitha universitetet partnere, si dhe partnerë të jashtëm. Fokusi i konferencës është se si aleanca mund të forcojë rajonet ku ndodhen, si dhe të rrisë bashkëpunimin mes këtyre rajoneve.

“Doctor Honoris Causa”

Presidentit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara Hanze, Z. Dirk Johan Pouwels, i'u dorëzua Titulli i nderit “Doctor Honoris Causa” në një ceremoni të posaçme të organizuar në sallën e Konferencave në godinën e Kampusit Universitar, me motivacionin: “Për ndikimin e tij në ndërkombëtarizmin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” nëpërmjet krijimit të Aleancës Universitare Europiane, duke mundësuar bashkëpunime transnacionale në të gjithë Europën e më gjerë duke frymëzuar transformimin e arsimit të lartë”.

Ky titull u dorëzua nga Rektoria e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Prof. Dr Kseanela Sotirofski, e cila vlerësoi rolin e z. Pouwels për ndikimin e tij të çmuar në përzgjedhjen e universitetit tonë për të qenë anëtar me të drejta të plota në Aleancën e Universiteteve Europiane STARS EU, e cila më mbështetjen e Bashkimit Europian, po arrin të krijojë sinergji fantastike mes universitetesh të ndryshme në hapësirën evropiane.



Universiteti West

Në datat 5-6 Dhjetor 2023 në Universitetin West, Trollhatan në Suedi, u zhvillua takimi i parë Kick-Off i Aleancës së Universiteteve Europiane STARS EU, ku Universiteti "Aleksandër Moisiu" është anëtar!

Anëtarët e Grupëve të Punës dhe të Grupeve Tematike shkëmbyen ide dhe ndan detyrat për përbushjen e objektivave dhe implementimin e këtij projekti për vitet në vijim për krijimin e një Universiteti Evropian të orientuar drejt së ardhmes.



STARS EU – Open Day

Takimin informues mbi STARS EU – Open Day, në Kampusin Universitar të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, ku studentët tanë patën mundësi të njiheshin më nga afër me misionin dhe vizionin e Aleancës Rajonale të Universiteteve Europiane STARS EU, të mësonin se çfarë u ofron STARS EU studentëve të UAMD-së dhe se si mund të bëhen pjesë e aktiviteteve të ndryshme që synojnë të zgjerojnë horizontin akademik dhe profesional të studentëve.

Një dritare drejt Aleancës Stars EU!





HANZE UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES (HANZE), GRONINGEN, NETHERLANDS

Delegacionin i UNIVERSITETIT të SHKENCAVE të APLIKUARA HANZE, GRONINGEN, HOLLAND të cilët janë lider të Alencës Europiane STARS EU, ku UAMD është partner së bashku me 9 Universitete të tjera Europiane.

Gjatë vizitës së tyre, përfaqësues të HANZE ndoqën dhe vlerësuan kapacitetet e UAMD dhe diskutuan rreth tematikave të ndryshme për vijimin e bashkëpunimit të frytshëm në të ardhmen. Gjatë Agjendës ata u bënë pjesë e një tryeze të rrumbullakët me partnerët strategjikë të biznesit në UAMD.

BIP "Startup Simulation Game"

Nga data 4 deri më 8 Dhjetor 2023, Java Intensive e STARS EU "Start Up Blended Intensive Programme" u zhvillua në HANZEUS që priti këtë program.

Një lojë simuluese është përdorur si një mjet simulimi i menaxhimit në internet, i përgatitur, udhëhequr dhe ndjekur nga leksione, seminare dhe trainime nga Lektor nga universitetet pjesëmarrëse. BIP "Startup Simulation Game" është një nismë e Grupit Tematik të Interesit të STARS EU, (TIG) "Sipërmarrje dhe Inovacion".



Takimi i parë i Projektit të Aleancës STARS EU për vitin e ri akademik 2024, me stafin akademik dhe administrativ në UAMD!



Lançimi Konferencës Vjetore 2025

Rektoria e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, ka lançuar datat për konferencën vjetore të STARS EU, e cila do të zhvillohet në Shqipëri në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, në datat 20-21 Mars, 2025. Delegatë nga të 9-të universitetet partnerere, por jo vetëm do të mirepriten në Shqipëri gjatë kësaj konference.



Mbjellja e Fidanëve

Prof. Dr. Kseanela Sotirofski – Rektor

“Ndërsa shikojmë përpara për vitin e ardhshëm, le të mbajmë me vete frymën e unitetit, përkushtimit dhe edukimit. Le të vazhdojmë të mbjellim farat e suksesit, duke e ditur se me çdo hap që hedhim, ne po krijojmë një të ardhme më të ndritshme për veten dhe për universitetin tonë së bashku me Alenacën e Universitetve STARS EU.”

Znj. Dorinela Cupi – Drejtor

Drejtorja e Projekteve dhe Marrëdhënieve

Ndërkombëtare

“Është frymëzuese të shohësh se si universiteti ynë nxit një kulturë rritjeje dhe bashkëpunimi. Këto fara përfaqësojnë potencialin brenda secilit prej nesh dhe fuqinë e përpjekjes së përbashkët për të arritur qëllime të jashtëzakonshme.”

Xhoen Xhoi – Student

“Të jesh pjesë e aleancës STARS EU do të thotë të përqafosh qëndrueshmërinë në çdo gjë që bëjmë. Mbjellja e këtyre fidanëve nënkupton përkushtimin tonë për të ushqyer jo vetëm bimët, por edhe mjedisin dhe komunitetin tonë akademik.”



Thematic Interest Group (TIG) – Digital Transformation, Bremen, Gjermani

Më datë 21 deri më 23 Nëntor 2023, në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Bremenit, Gjermani. "TIG-u Digital Transformation" u zhvillua si pjesë e "International Week", duke sjellë së bashku ekspert, inovatorë duke eksploruar temën "Digital Campus".

Ky takim ishte një mundësi e jashtëzakonshme për të ndarë njohuri, përvoja dhe praktika më të mira për transformimin digjital në arsimin e lartë. Me një fokus të veçantë në krijimin e kampuseve digjitale që përgjigjen në mënyrë dinamike ndaj nevojave të studentëve dhe mësimdhënësë sot, diskutimet dhe njohuritë ishin jo vetëm frymëzuese por edhe praktike.



Universiteti Politeknik Bragança priti edicionin e dytë të suksesshëm të IN2COP me partnerët e STARS EU

Edicioni i dytë i Konferencës Ndërkombëtare për Procesin e Bashkë-Krijimit (IN2COP) u mbajt në Universitetin Politeknik Bragança, duke shënuar një bashkëpunim të rëndësishëm me partnerët e STARS EU. Personalitete të shquara si Vanessa Dubois, nga Komisioni Evropian dhe Tia Loukoula, nga OECD, dolën në skenë si folës plenare, duke ndezur diskutime të thella mbi të ardhmen e arsimit të lartë brenda kuadrit të Aleancave Europiane dhe peizazhit në zhvillim të aftësive të ardhshme të kërkuara nga tregun e punës.



Healthy Aging, pjesë e Grupeve Tematike të STARS EU



Në datat 31 Tetor dhe 1-2 Nëntor, UAMD pati kënaqësinë të mirëpriste një grup kolegësh dhe përfaqësuesish nga Universiteti i Selesian, Çeki dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara HANZE, Hollandë në kuadër të programit të shkëmbimeve dhe trajnimeve të Healthy Aging, pjesë e Grupeve Tematike të STARS EU, një mundësi e shkëlqyer për të ndarë përvojat dhe njohuritë në fushën Healthy Aging.

